VENDIM
Nr. 587, datë 22.7.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL

(ndryshuar me VKM nr. 758, datë 23.9.2020, nr. 936, datë 25.11.2020; nr. 111, datë 24.2.2021; nr. 405, datë 30.6.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, shkronja "a", pika 1, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 18 441 909 064 (tetëmbëdhjetë miliardë e katërqind e dyzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

2. Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

2.1 Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 666 179 207 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekësh pa TVSH.

3.1 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 666 179 207 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

Efekti financiar sipas kësaj pike të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama